

VENDIM
Nr. 800, datë 14.11.2012

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 41, DATË 11.1.2012 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET BAZË, SEKTORËT QË DO TË MBËSHTETEN DHE MASËN E
PËRFITIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL PËR
VITIN 2012”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” dhe të nenit 15 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 41, datë 11.1.2012 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë vijon:

1. Në kreun VII, fjalët “... 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekë ...” zëvendësohen me “... 100 000 (njëqind mijë) lekë ...”.

2. Pas kreut VII shtohet kreu VII/1 me këtë përmbajtje:

“VII/1. Shuma prej 69 900 000 (gjashtëdhjetë e nëntë milionë e nëntëqind mijë) lekësh do të kalojë për të financuar skemat kombëtare të mbështetjes së fermerëve në prodhimin bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha